

BUSINESSEUROPE



BUSINESS8MACEDONIA

**BOSMIP**  
Bringing Business Together

# Manual për vlerësimin e rrezikut profesional



EU Co-funded project

# Manual për vlerësimin e rrezikut profesional

Realizues:

Punëdhënësve Konfederata së Maqedonase

BUSINESSEUROPE

Mbështetje profesionale:

Punëdhënësve Konfederata së Maqedonase

Tirazhi:250

Shkup, 2011

# **Përmbajtja**

- 1. Hyrje**
- 2. Objektivi kryesor i Manualit për vlerësimin e rrezikut profesional**
- 3. Bazat ligjore të vlerësimit të rrezikut**
- 4. Përgjegjësitë e punëdhënësve**
- 5. Objektivi kryesor për vlerësimin e rrezikut**
- 6. Rreziku, rrezikshmëritë dhe ndarja**
- 7. Reduktimi i rrezikut nëpër faza**
- 8. „Hapat“ gjatë vlerësimit të reduktimit të rrezikut**
- 9. Mbajtja e evidencës – shënim/deklaratë për siguri**
- 10. Rregullorja për hartimin e deklaratës për siguri**
- 11. Informata**

# 1. Hyrje

Siguria në punë dhe shëndeti i punëtorëve të ekspozuar profesional nuk paraqet vetëm një qasje formale me të cilën komuniteti dëshiron ta deklarojë përcaktimin e vet lidhur me avancimin e mjedisit të punës dhe mirëqenien e punëtorëve. Përkundrazi, kjo është një kategori me orientim të lartë ekonomik, me të cilën duhet të mbrohen interesat e punëtorëve, ndërmarrjeve, kompanive!!

E drejta për shëndet dhe e drejta për siguri në punë janë të drejta universale të njeriut dhe të punës. Prandaj, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) nga themelimi i saj e deri më sot ka miratuar dhe publikuar 187 deklaratë dhe 198 rekomandime nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës, u inkorporua një nocion i ri dhe njëkohësisht një mënyrë dhe procedurë e re në drejtim të reduktimit të ndikimeve të dëmshme në procesin e realizimit të detyrave të punës në vendin e punës.

Rreziku!!! I krijuar nga kushtet jopërkatese të punës, nga vendet e pasiguruara të punës prej të cilave paraqiten lëndime në vendin e punës dhe sëmundje profesionale.

Vlerësimi i rrezikut është bazë për vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm, ndërkaq vetë procesi i vlerësimit të rrezikut është përgjegjësi ndaj punëtorëve për nxitjen e sigurisë, motivimit dhe besimit të tyre ndaj ndërmarrjes. Vlerësimi i rrezikut është indikator i orientimit të qëndrueshëm afatgjatë të ndërmarrjes, përmirësimit të kapaciteteve, produktivitetit dhe profitit.

Hartimi i deklaratës për siguri, do të thotë përgatitje dhe sigurim të vendit të sigurt të punës.

Sistemet bashkëkohore, funksionale dhe të harmonizuara lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë, ashtu siç janë inkorporuar në shumë vende të zhvilluara dhe në të gjitha vendet anëtare të BE-së, kryesisht janë të orientuara kah nevoja për ruajtjen dhe rritjen e interesave ekonomike të punëdhënësve. Pikërisht për këtë imponohet domosdoshmëria e implementimit sa më të shpejt të legjislacionit evropian, normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian (BE), të Organizatës Ndërkombëtare të Punës(ONP) dhe të Organizatës Shëndetësore Botërore(OSHB) në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit të punëtorëve.

Falë vlerësimit të BUSINESSEUROPE dhe Punëdhënësve Konfederata e Maqedonase, lidhur me nevojën e përmirësimit të gjendjes në segmentin e sigurisë dhe shëndetit në punë, u hartua Manuali për vlerësimin e rrezikut profesional si mjet themelor për qasje në rregullat dhe normat e sigurimit të drejt të vendit të sigurt të punës.

## **2. Objektivi kryesor i Manualit për vlerësimin e rrezikut profesional**

- T'u dilet në ndihmë ndërmarrjeve dhe veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që ta kuptojnë procesin e vlerësimit të rrezikut (VR) dhe rëndësinë e tij.
- Të sigurohet instrumenti me të cilin do t'u mundësohet ta bëjnë vetëvlerësimin e rrezikut.
- Të sigurohet qasje deri te burimet e informatave të rëndësishme lidhur me rrezikun profesional në një veprimtari relevante të ndërmarrjes.

## **3. Bazat ligjore të vlerësimit të rrezikut**

- Punëdhënësit kanë detyrim të përgjithshëm që të sigurojnë siguri dhe shëndet për punëtorët në të gjitha aspektet lidhur me punën e tyre.
- Vlerësimi i rrezikut mundëson që punëdhënësit t'i zbatojnë masat e domosdoshme specifike lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve.
- Në kuadër të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, të gjithë punëdhënësit doemos duhet rregullisht ta bëjnë vlerësimin e rrezikut. (Direktiva kornizë 89/391, e përfshirë në legjisllacionin nacional).

## **4. Përgjegjësitë e punëdhënësve**

Punëdhënësi e ka për detyrë:

- Ta organizojë vlerësimin e rrezikut
  - Të caktojë personin/personat për zbatimin e vlerësimit të rrezikut dhe të sigurohet se të njëjtit janë kompetent për realizimin e detyrës
  - T'i inkorporojë masat parandaluese dhe mbrojtëse
  - T'i inkuadrojë punëtorët në procesin e vlerësimit të rrezikut
  - T'i konsultojë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre lidhur me organizimin e vlerësimit të rrezikut
  - T'i grumbullojë raportet e vlerësimit të bërë mbi rrezikun dhe t'i bëjë të aksesshëm për punëtorët dhe /ose përfaqësuesit e tyre
- 
- Të sigurohet se të gjithë punëtorët janë të informuar në lidhje me të gjitha dëmet, me të gjitha efektet negative potenciale dhe me të gjitha masat parandaluese

## **5. Objektivi themelor për vlerësimin e rrezikut**

Punëdhënësi të ndërmarrë një sërë masash në lidhje me vendin e sigurt dhe të shëndetshëm për përmbushjen e detyrave të punës:

- Parandalim të rrezikut profesional,
- Informim të personelit - të punësuarve në ndërmarrje,
- Trajnime,

- Zbatim të organizuar të masave.

Vlerësimi i rrezikut përsëritet gjatë çdo ndryshimi të kushteve, mjedisit, teknologjisë dhe materialeve.

Vëmendje e veçantë duhet t'i përkushtohet zbatimit të masave të reja dhe eliminimit të rreziqeve dhe rrezikshmërive me ç'rast duhet pasur kujdes që gjatë eliminimit të një rreziku të mos krijohet rrezik tjetër.

## 6. Rreziku, rrezikshmëritë dhe ndarja

### Përkufizimi:

Me nocionin **rrezik** nënkuptohet masa e shprehur kuantitative e mundësisë-probabilitetit që si rezultat i ekspozimit të shfaqen efekte të dëmshme mbi shëndetin dhe jetën e punëtorëve të ekspozuar profesional.

Burime të rrezikshmërisë dhe **rrezikut** janë materia, sendet, vendi dhe mjedisi i punëtorëve në vendin e punës. Gjatë analizave permanente dhe ndjekjes permanente të kushteve në vendet e punës që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt mbi shëndetin e personelit të përgjithshëm të ndërmarrjeve, vlerësimi i rrezikut ndikon mbi reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve.

**Rreziku** paraqet përmbledhje të dy komponentëve:

**1. Probabiliteti për shfaqjen e faktorëve të dëmshëm në mjedisin e punës.**

**2. Probabiliteti për shfaqjen e efekteve negative konsekuente mbi shëndetin e punëtorëve të ekspozuar.**

### Rrezikshmëritë dhe ndarja

Rrezikshmëritë ndahen sipas llojit dhe natyrës së rrezikut edhe atë:

- Mekanike

- Pajisja dhe mjetet e punës nuk janë standardizuar konform rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë
- Përdorimi joadekuat, mirëmbajtja dhe kontrolli e servisimi periodik
- Sende në lëvizje dhe zhvendosja – të mprehta, me majë dhe të papërpunuara
- Lëndime fizike gjatë zhvendosjes – ngritjes, shtyrjes, hedhjes dhe tërheqjes
- Vegla manuale
- Sende të nxehta ose të ftohta
- Përfshirja e pjesëve të pajisjes personale për mbrojtje
- Gabime në vendosjen e konstruksionit

-Rreziku nga energjia elektrike

- Kontakti me aparatet përçuese elektrike të pambrojtura dhe me veglat nën tension
- Manual për vlerësimin e rrezikut profesional

- Rrufeja dhe shkarkimi elektrik
- Rreziku nga transporti dhe lëvizja
- Lëvizja: dysHEME ose trase e lëmuar, e rrëshqitshme, e parrafshët dhe e papastër
  - Rrëzimi: skela, lartësi pa mbrojtje, shkallë, kthesa
  - Ortek materialesh
- Zjarri dhe shpërthimet
- Instalim i pambrojtur që lehtë mund të digjet dhe materiale djegëse
  - Materie djegëse të lëngshme, karburante dhe materiale djegëse
- Fizike dhe Kimike
- Temperatura e ulur ose e rritur e atmosferës dhe kushtet mikro-klimaterike
  - Energjia mekanike
  - Helme industriale
  - Pluhur, mjegull, avull-organik dhe joorganik nga prodhimtaria
  - Ndriçimi
- Biologjike
- Infeksione
  - Mikroorganizma
  - Gjallesa dhe bimë
- Angazhimi psikik dhe fizik
- Pozitë joadekuatë e trupit
  - Shkallë e lartë e përgjegjësisë, motivim i vogël, detyra pune me stres
  - Angazhimi fizik – veprimtari me punë intensive

## 7. Reduktimi i rrezikut nëpër faza:

- Identifikimi

- **Kontrolle profesionale inxhinierie** (mjete fizike)

- **Reduktimi/zëvendësimi**

- **Eliminimi** (përfshinë eliminimin e rreziqeve ose ndonjëherë shmangien e rreziqeve, për shembull, eliminimin e rrezikut nga ndërkëmbjet, shmangien e punës në lartësi etj.)

- **Sisteme të sigurta të punës**, informata, udhëzime, trajnime, mbikëqyrje, kontrolle dhe testime përkatëse etj. (mjete jofizike)

- **Pajisje për mbrojtje personale**

## 8. „Hapat“ gjatë vlerësimit të reduktimit të rrezikut

## Hapi 1:

### Identifikimi i dëmit dhe ekspozimi

Aktivitetet e domosdoshme për identifikimin e dëmit përfshijnë:

- Vizitë dhe kontroll të vendit të punës dhe detektimin e dëmeve që mund të shkaktojnë dëmtime.
- Konsultime me punëtorët dhe/ose me përfaqësuesit e tyre në lidhje me problemet me të cilët ata ballafaqohen.
- Analizë e ndikimeve permanente të dëmeve mbi shëndetin (niveli i lartë i zhurmës ose i substancave të rrezikshme), dhe jo vetëm i rreziqeve evidente.
- Analizë e të dhënave të kompanisë për aksidentet, lëndimet dhe sëmundjet.
- Kërkimi i të dhënave nga burime të tjera për:
  - ▶ Udhëzues dhe deklarata të prodhueseve dhe furnizuesve.
  - ▶ Internet faqe për siguri dhe shëndet në punë.
  - ▶ Mundësi ligjore dhe kërkesa të tjera që kanë të bëjnë me vendin e punës.
  - ▶ Informata për dëmin dhe ndikimet e dëmshme.
- Për dëmin me rëndësi është të dihet:
  - ▶ Cilët janë grupet e punëtorëve që mund t'i ekspozohen rrezikut nga aspekti profesional
  - ▶ Në ç'mënyrë punëtorët vijnë në kontakt me dëmin (ekspozim i drejtpërdrejt ose i tërthortë)
  - ▶ Si ata mund të preken-lloji i lëndimeve ose sëmundjeve që mund të paraqiten
- Vëmendje e posaçme duhet t'u përkushtohet grupeve të punëtorëve vulnerabil varësisht nga gjinia e tyre dhe/ose kërkesave të tjera eventuale që mund ta rrisin rrezikun:
  - ▶ Të punësuar me aftësi të kufizuar
  - ▶ Punëtorë të rinj dhe më të moshuar
  - ▶ Gra shtatzënë dhe gra me foshnjë në gji
  - ▶ Punëtorë të patrajnuar dhe me përvojë të pamjaftueshme (të punësuar të ri, punëtorë të angazhuar me punë sezonale ose punë jashtë orarit)
- Përdorimi i listës së përgjithshme për kontroll

## Hapi 2:

### Evaluimi dhe prioriteti i rrezikut

•Që të vendoset lidhur me atë se a është rreziku I VOGËL; I MESËM; ose I MADH, duhet ta kemi parasysh:

▶ Nivelin e probabilitetit se dëmi do të shfaqet dhe do të shkaktojë efekte të dëmshme negative,

▶ Në ç'masë është serioziteti/rëndësia e dëmtimit,

▶ Sa shpesh dhe sa punëtorë i ekspozohen dëmit.

•Vlerësimi që mbështetet mbi gjykimin pa përmbushjen e shkathtësive dhe teknikave të veçanta mund të jetë i mjaftueshëm për:

▶ Punë me dëme të cilat shkaktojnë shqetësime të vogla

▶ Vende pune në të cilat rreziku është i identifikuar dhe në të cilat ekziston mundësi për kontroll

•Në rast të dëmeve ose aktiviteteve më komplekse, mund të kërkohet njohuri, mbështetje dhe këshilla profesionale.

## Hapi 3:

### Vendimi për masa parandaluese

Në rastin kur do të konstatohet se nevojitet të ndërmerren masa parandaluese dhe mbrojtëse, doemos duhet të merret parasysh:

•A mund të shmanget ose eliminohet rreziku dhe nëse JO:

•Si mund të minimizohet ose kontrollohet rreziku që të mos e komprometojë sigurinë dhe shëndetin e personave të ekspozuar profesional edhe atë përmes:

▶ Përbaljes me rrezikun në vendin e burimit

▶ Përshtatjes së punës ndaj punëtorit

▶ Përshtatjes me teknikat bashkëkohore, njohuritë dhe informatat

▶ Zëvendësimin të substancave të rrezikshme me substanca të parrezikshme ose me substanca më pak të rrezikshme

▶ Zbatimit të masave organizative dhe kolektive për mbrojtje para përdorimit të mjeteve mbrojtëse personale

▶ Dhënies së informatave dhe instruksioneve përkatëse punëtorëve

## Hapi 4:

### Ndërmarrja e aksionit

- Hapi i operacionalizimit të masave mbrojtëse parandaluese.
- Implementimi efikas i masave përmes zhvillimit të planeve duke e përcaktuar:
  - ▶ Kush për çka është përgjegjës,dhe çka punon
  - ▶ Kur aktiviteti do të përfundojë tërësisht
  - ▶ Mjetet e dedikuara për implementimin e masave.

## Hapi 5:

### Ndjekja dhe kontrolli i vlerësimit

- Efikasiteti i masave të ndërmarra parandaluese dhe korigjuese duhet të ndiqet në kontinuitet.
- Vlerësimi duhet sërish të kontrollohet dhe revidohet po qe se një gjë e këtillë është e nevojshme, veçanërisht nëse:
  - ▶ Çdoherë kur do të ndërmerren ndryshime të rëndësishme organizative në punë
  - ▶ Si rezultat i informatës së re që ka të bëjë me analizën e lëndimeve dhe aksidenteve në punë
  - ▶ Në rastin kur masat e ndërmarra parandaluese janë të pamjaftueshme apo më nuk janë efikase
  - ▶ Që të sigurohet se të dhënat nga vlerësimi i rrezikut janë akoma relevante

**ÇEK-LISTA E PËRGJITHSHME**

NR.	RREZIKU	PO	JO	NUK E DI (shih çek-listën speciale të rreziqeve)
1.	Sipërfaqe të parrafshëta dhe rrëshqitëse që mund të shkaktojnë rrëshqitje, ndërkëmbje, rrëzim etj.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
2.	Lëvizja e automjeteve dhe makinave	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
3.	Pjesë të lëvizshme të makinave	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
4.	Sende dhe pjesë me sipërfaqe të rrezikshme (të mprehta,të ashpra etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
5.	Sipërfaqe dhe materiale të nxehta apo të ftohta etj.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
6.	Vende pune në lartësi dhe pikat e ngjitjes (që mund të shkaktojnë rrëzim nga lartësia)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
7.	Vegla manuale	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
8.	Tensioni i lartë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
9.	Instalime dhe pajisje elektrike	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
10.	Zjarri	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
11.	Shpërthimi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
12.	Substanca kimike (përfshirë edhe pluhurin) në ajër	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
13.	Zhurma	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
14.	Vibracione – dorë/sup	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
15.	Vibracione – i tërë trupi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
16.	Ndriçimi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
17.	Rrezatime laseri dhe mikro-valë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
18.	Fushë elektromagnetike	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
19.	Klimë e nxehtë ose e ftohtë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
20.	Ngarkimi dhe shkarkimi i ngarkesave	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
21.	Qëndrimi jo i drejtë i trupit gjatë punës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
22.	Rreziqe biologjike (viruse, parazitë, kërpudha, baktere)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
23.	Stresi, dhuna, abuzimi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	

XXX . XXX

EMËRTIMI I FIRMËS

Numri rendor i vend. të pun.

### TË DHËNA TEKNOLOGJIKE PËR VENDIN E PUNËS

Vendi i punës (emërtimi):		
Kërkesa të posaçme (a është vendi i punës me kushte të posaçme për punë):		
Regjimi i punës:	<ul style="list-style-type: none"><li>- Fondi javor i orarit të punës:</li><li>- Orari i punës:</li><li>- Fshehja e turnit:</li><li>- Pushim javor:</li><li>- Pauzat gjatë punës:</li></ul>	
Gjithsej të punësuar në RM	Meshkuj	
	Femra	
	Më të rinj se 18 vjeç	
	Nr. i invalidëve të punës	
Përshkrimi i detyrave të punës	1.	

Mjetet e punës		
Ambienti i punës	Emërtimi i ambientit	% koha
Ambient i mbyllur:		
Ambient i hapur:		
Ambient tjetër:		

## 9. Mbajtja e evidencës – shënim/deklaratë për siguri

•Për vlerësimin e bërë mbi rrezikun medoemos duhet të ekzistojë evidencë përkatëse në një formë të caktuar të shkruar – deklaratë për siguri.

•Çdo shënim/deklaratë për siguri mund të përdoret për:

- ▶ Sigurimin e informatave për personat përgjegjës
- ▶ Vlerësimin nëse janë ndërmarrë masat e domosdoshme parandaluese
- ▶ Përgatitjen e evidencës për organet inspektuese
- ▶ Revizionin e masave nëse janë ndryshuar kushtet e vendit të punës

•Shënimi-Deklarata për siguri hartohet sipas rregullores konform Ligjit për MSP

## 10. Rregullorja për hartimin e deklaratës për siguri

**RREGULLORE PËR HARTIMIN E DEKLARATËS PËR SIGURI, PËRMBAJTJA E SË NJËJTËS, SI DHE TË DHËNAT MBI TË CILAT DUHET TË BAZOHET VLERËSIMI I RREZIKUT (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 02/09)**

- Përcaktimi i mënyrës së hartimit të deklaratës për siguri, përmbajtja e së njëjtës, si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut në punë.

**–Detyrimi i PUNËDHËNËSIT !!!!**

– Hartimi i deklaratës për siguri bëhet sipas **Vendimit** të miratuar nga punëdhënësi për hapjen e procedurës për vlerësimin e rrezikut.

- Punëdhënësi cakton një ose më shumë persona profesionistë nga radhët e të punësuarve të cilët janë përgjegjës për zbatimin e procedurës për vlerësimin e rrezikut.

### DEKLARATA PËRMBAN

- datën e lëshimit të deklaratës;
- të dhënat e personave që marrin pjesë gjatë përgatitjes së deklaratës për siguri me vlerësimin e rrezikut;
- të dhëna për kontrollet dhe analizat paraprake të mjeteve të punës;

- të dhëna për vendet e punës, njësitë organizative të punëdhënësit dhe numrin e të punësuarve;
- vlerësimin e rrezikut
- të dhëna për personat profesionistë për siguri në punë dhe për institucionin e autorizuar shëndetësor.

**Në bazë të informatave, deklarata sipas dokumentacionit duhet të hartohet në formë të shkruar - nga:**

**- PERSONA TË AUTORIZUAR PROFESIONISTË PËR SIGURI NË PUNË, DHE**

**- INSTITUCIONI I AUTORIZUAR SHËNDETËSOR,**

**në të cilën në formë të diagramit, simboleve, skicave, drafteve dhe të tekstit profesional përcaktohet dhe përshkruhet vendi dhe siguria.**

# 11. Informata

## Kontakte:

### Punëdhënësve Konfederata së Maqedonisë

„Vasil Gjorgov“ nr. 11	1000, Shkup	Tel. 02- 3224 762
„Stefan Dineski“ nr. 5	7500, Prilep	Tel. 048- 613 316
„Goce Dellçev“ nr. 5	1430, Kavadar	Tel. 043- 412 994

[www.cerm.com.mk](http://www.cerm.com.mk)

### Inspektorati Shtetëror i Punës

#### Kontakt informata të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe njërive rajonale

1. Shkup – ISHP (Centrali)	02 3116 – 110 , 02 3224 – 504 , 02 3296 – 310
2. Shkup - Qendër (OP)	02 3 220– 536 , 02 3213 – 184
3. Shkup – Gazi Babë ( MSP )	02 3115 – 104 , 02 3296 – 315 , 02 3296 – 316
4. Kumanovë	031 423 – 231 , 031 424 – 725
5. Kriva Pallankë	031 375 – 020 , 031 374 – 255
6. Kratovë	031 481 – 099
7. Probishtip	032 484 – 790
8. Sveti Nikolë	032 443 – 126
9. Shtip	032 383 – 503 , 032 383 – 563
10. Vinicë	033 361 – 644
11. Koçan	033 270 – 537
12. Dellçevë	033 411 – 737
13. Strumicë	034 349 – 280
14. Radovish	032 635 – 412
15. Vallandovë	034 382 – 856
16. Gjevgjeli	034 212 – 069
17. Berovë	033 471 – 212 , 033 470 – 072
18. Veles	043 239 – 174

Manual për vlerësimin e rrezikut profesional

19. Kavadar	043 412 – 480
20. Negotinë	043 361 – 461
21. Tetovë	044 352 – 760 , 044 352 – 761
22. Gostivar	042 216 – 500
23. Dibër	046 831 – 119
24. Kërçovë	045 225 – 170
25. Manastir	047 242 – 725
26. Demir Hisar	047 276 – 321
27. Ohër	046 257 – 670
28. Prilep	048 427 – 448
29. Resnjë	047 452 – 332
30. Strugë	046 783 – 139
31. Makedonski Brod	045 275 – 232

### **Informata për tekstin**

**Materiale të shfrytëzuara nga dokumentacioni për siguri dhe shëndet në punë, analiza profesionale, punime shkencore, strategji, direktiva, enciklopedi nga:**

- **Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës**
- **Enti Republikan për Mbrojtje Shëndetësore**
- **Legjislacioni i punës**
- **SHMMGjP**
- **PKM**
- **Instituti i Mjekësisë së Punës**
- **Konventa të ratifikuara**
- **Strategjia e Bashkimit Evropiane**